



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**  
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

**P.nr.1116/2018**

**NË EMER TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal**, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Gezim Ademi, procesmbajtëse Hasnije Muhaxheri, ne çështjen penale ndaj te pandehurit B.P nga ..., i akuzuar për veprën penale: *Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 e lidhur me par.6 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës* (më tej i referohemi me shkurtesën KPRK), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë - Departamenti i përgjithshëm PP.nr.1624/2018, dt.05.12.2018, te cilën aktakuze e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Natasha Radoviq, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit gjyqësor dhe publike, me dt.16.07.2019, ne mungese te te pandehurit dhe prokurorit te shtetit është marre dhe shpallur publikisht aktgjykimi, ndërsa aktgjykimi është përpiluar me dt.09.08.2019;

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari;**

**B.P, nga i ati F., e ëma A., e gjinisë B., i lindur me ... ne ..., me vendbanim rr.”...” ne Mitrovicë, me numër personal ..., ka te kryer fakultetin, i martuar, baba i një fëmije, i pa dënuar me pare, Shqiptar, shtetas i Kosovës.**

**ËSHTË FAJTOR**

**SEPSE:** me dt. 23.07.2016 rreth orës 15:45 në rr. “...” në afërsi të stadionit “...”, duke vozitur automjetin e ti në mënyrë të shkujdesur, konsideroj se nuk do të vij deri te aksidenti i trafikut ose do të mund ta shmang atë, hyri në udhëkryq ku dendësia ishte e tillë që nuk mundi të ndalet në udhëkryq ose në kalimin e këmbësorëve andaj në kundërshtim me nenin 64 të Ligjit mbi sigurinë e trafikut rrugor, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin motorik të udhëtarëve të tipit “VW Caddy”, ngjyrë e bardh, me targa ..., me të arritur në udhëkryqin te stadioni “...” me pjesën e përparme të anës së djathë automjetit të tij goditi Biçiklistin B.H, i cili ishte duke lëvizur nga ana e djathë e rrugës i cili me këtë rast bie nga biçikleta, dhe pëson lëndime të rënda trupore – thyerje – frakture kompresive të unazave TH11, TH12 dhe L3.

Me këtë ka kryer veprën penale: **Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 të KPRK-së.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,23,41,45,73, dhe ne lidhje me nenin 378 par.8 lidhur me par.6 te KPRK-ës , e lidhur me nenin 365, 450 dhe 463 te KPP-ës e:

## GJYKON

**ME DENIM ME BURG ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj**, i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

OBLIGOHET i pandehuri qe ti paguaj shpenzime procedurale-paushallit gjyqësor shumën prej 20 (njëzet)euro, për ekspertizën mjeko-ligjore shumen prej 20 (njëzet) euro, ndërsa për ekspertizën e komunikacionit shumen pre 40.88 (katër dhjet) euro, ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit shumen prej 30(tridhjetë) euro, te cilat shpenzime i pandehuri është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Për Kërkesën pasurore juridike i dëmtuari udhëzohet ne kontest te rregull civil.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë- Departamenti i përgjithshëm, në Gjykatës Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.nr.1624/2018, dt.05.12.2018, ndaj te pandehurit B.P nga ..., nen dyshimin për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 e lidhur me par.6 e 1 te KPRK-ës.

Ne ketë çështje penale gjyqtari ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar dt.19.02.2019, gjate kësaj seance te shqyrtimit fillestar i pandehuri është udhëzuar dhe njoftuar me te drejtat e tij konform nenit 246 par.1 te KPP-ës, pas deklarimeve te te pandehurit është vazhduar me veprimet e tjera procedurale sipas KPP-ës, i pandehuri është deklaruar se e nuk e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet ne barre sipas aktakuzës.

Procedura ne ketë çështje ka vazhduar me mbajtjen e seancave te shqyrtimit gjyqësor dt.07.06.2019,e cila seance nuk është mbajtur për shkak te mungesës se dëshmitarit B.H, procedura ka vazhduar me seanca tjera te shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri është njoftuar me te drejtat ligjore ne ketë çështje penale, ne kuptim te nenit 323 par.1 dhe 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2,3 te KPP-ës, po ashtu edhe palët e dëmtuara ne kuptim te nënti 322 par.2 te KPP-se.

Prokurori i Shtetit Natasha Radoviq, gjate shqyrtimit gjyqësor por edhe ne paraqitjen e fjalës përfundimtare, ka deklaruar se mbetem pranë aktakuzës se ngritur sepse konsideroj se me provat e nxjerrura ne shqyrtimin kryesor ne tersi është vërtetuar qe i pandehuri ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 te KPRK-ës dhe njëherit gjykatës i ka propozuar qe te njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari-dëshmitari ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkrahi ne tersi fjalën përfundimtare te prokurorit te shtetit ne tersi ashtu siç ka deklaruar.

I pandehuri ne fjalën përfundimtare deklaroi: unë kam deklaruar me pare për ketë çështje penale dhe nëse ekspertiza me qet fajtor atëherë edhe jam fajtor.

Ne cilësinë e dëshmitarit-dëmtuarit ka dëshmuar dëshmitari B.H dhe i njëjti ne ketë seancë ka deklaruar: me datën 23.07.2016 rreth orës 15:45min kam qene te rruga “...” te ... afër tregut duke e

drejtuar biçikletën dhe kur kam qene duke u lidhur ne rruge ne atë moment i pandehuri me ka rrokur me automjet, ne momentin kur me ka goditur nuk ka pasur automjete tjera përpos i pandehuri dhe me ka goditur me anën e përparme te veturës. Unë isha duke shkuar rrugës në drejtim të stadionit, për me kalu udhëkryqin për ne drejtim te tregut, mirëpo kur kam hasur te rruge kryqi dhe kam vazhduar ne drejtimin tim ne udhëkryq ku ka qene ana e djathte e imja dhe me tu kyçur ne rruge kam respektuar krahun tim, dhe aty ka ardhur i pandehuri dhe me ka goditur i njëjti ka qene me një shpejtësi te madhe mua ne atë rast me është shtrembëruar biçikleta dhe me ka rrëshqitur se ka qene rruga e lagur dhe ne atë moment kam ra ne toke ku pasi qe kam ra ne toke vetura e te pandehurit me ka godit ne shpine dhe aty kam pësuar lëndime te renda trupore, dhe ne atë rast i pandehuri me kanë dërguar ne spital ku me është dhëne ndihma e pare dhe me është bere një rengel ku ne rengel është vrenjtur se unazat e shpinës kanë qene te thyera dhe nga aty me kanë dërguar me ndihme te shpejt ne ... dhe aty kam qëndruar 5 dite para operacionit, si dhe pas operacionit kam qëndruar edhe 8 dite tjera, kam pasur operacion te thelle i kam pasur protezat te unazat dhe kam pasur vidën te ngjitur tek unazat, dhe ato i kam pasur te ngjitura diku rreth 2 vite e 6 muaj dhe pas 2 viteve prape ju kam nënshtruar operacionit dhe i kam hjekur vidat nga trupi por jo ne tersi, mua gjithherë me përcjellin pasojat nga ky aksident kam dhimbje ne shpine si dhe rregullisht duhet tju nënshtrohem terapive fizikale çdo 6 muaj dhe nuk mund te tërheq asgjë me shume se 5 kilogram si dhe kam pasur probleme ne qafë. Unë nuk kam qene ne shpejtësi te madhe ne momentin kur kam hyrë në kryq dhe me qenë se kam qene me shpejtësi te vogël unë i kam respektuar edhe rregullat ne komunikacion, dhe kam hyre ne skajin e rrugës kah ana ime, meqenëse unë kam qene ne rrugën time mua vetura nga i pandehuri me ka goditur pas shpine dhe me ka goditur edhe pasi qe fillova te kyçna ne rrugën time kah isha drejtuar te shkojë.

Pasi qe nuk ka pasur propozime te tjera, procedura ka vazhduar me leximin e provave, raporti i policisë se Kosovës vitit ... i datës 23.07.2016, raporti i oficerit policor i datës 23.07.2016, raporti i aksidentit te komunikacionit i datës 12.08.2016, flet lëshimi i klinikes repartit te Otopsisë me nr.... i datës 23.07.2017, polisa e sigurimeve "Prising" i datës 13.04.2016, raporti mbi aksidentin i policisë se Kosovës nr. 02.32144 i datës 23.07.2016, ekspertiza mjeko-ligjore e datës 02.06.2018, ekspertiza e ekspertit te trafikut i datës 07.09.2017 dhe foto dokumentacionin.

Pas leximit te provave, Prokurori i shtetit, dëshmitari-dëmtuari dhe i pandehuri kane deklaruar se nuk kanë propozime te tjera sa i përket procedurës se plotësimit te provave dhe procedura ka vazhduar me marrjen ne pyetje te të pandehurit.

I pandehuri B.P gjate procedurës për marrjen ne pyetje ne cilësinë e te pandehurit ka deklaruar se me dt.23.07.2016 ne orën 15:45min, kam qene duke shkuar ne ... unë kam qene ne automjet kushtet atmosferike kane qen me shi nuk ka pasur pjesëmarrës se tjerë ne komunikacion kam hyre ne kryqin ne anën e djathtë duke hyre i dëmtuari ne anën e majte ka ndërhy, nuk kam vrenjtur asnjë person me biçiklete sepse ka qene moment, nuk mundem me dite se sa kam qene ne shpejtësi, unë kam qene duke u kthyer ne anën e djathte dhe ai ka ndërhy ne anën e majte dhe atëherë ka ardhur deri te kontakti, unë kam ndaluar automjetin ne ato momente i kam dhëne ujë me pi dhe nga aty e kemi dërguar ne spital. te dëmtuarin unë e kam goditur kur kam filluar qe te kthehem nga ana e djathte për me hy ne rrugën ka dëshiroja te vazhdoja, te dëmtuarin e kam goditur me skajin e kryqit duke u kthyer nga drejtimi im ne pjesën e djathte, me pjesën e përparme te veturës.

Gjykata pas procedimit te provave te kësaj çështje penale gjatë këtij shqyrtim gjyqësor, paraqitjes se mbrojtjes nga ana e te pandehurit, dhe te vlerësimit te tyre një nga një dhe ne lidhje me provat tjera, gjykata ne mbështetje te nenit 361 par.2 te KPP-es, ka vërtetuar gjendjen faktike si ne dispozitiv te

aktgjykimit, dhe atë duke u provuar se ne veprimet e te pandehurit kemi te bëjmë me veprën penale: Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 e lidhur me par.6 KPRK-se, kjo vërtetohet ne baze te provave te administruara gjate këtij shqyrtimi gjyqësor pasi qe nuk është kontestuese për gjykatën se ditën kritike dt.23.07.2016, i pandehuri ka qene duke e drejtuar Automjetin e tipit “VW Cady” me targa ... ngjyre e bardhe, kjo vërtetohet nga foto dokumentacioni, nga skica e vendit te ngjarjes, po ashtu nuk mohohet as nga vet i pandehuri, po ashtu vërtetohet fakti se ne ditën kritike ka ndodhur aksidenti ne mes te pandehurit i cili ishte duke e vozitur veturën te cekur me larte me te dëmtuarin i cili ishte duke e drejtuar biçikletën, ky fakt vërtetohet përveçse nga provat materiale qe gjenden ne shkresat e lendes edhe nga vet i pandehuri, fakti se i pandehuri e ka kryer veprën penale per te cilën ngarkohet sipas aktakuzës vërtetohet edhe nga ekspertiza e komunikacionit e dhëne me shkrim dt.07.09.2017, ku ka konstatuar se lëshimet ekskluzive i përkasin drejtuesit te automjetit “VW Cady”, te cilën e ka drejtuar i pandehuri B.P, po ashtu eksperti i mjekësisë ligjore Dr. F.B, i cili ekspertizën e dhëne me shkrim dt. 02.06.2018, ka theksuar për te dëmtuarin B.H se ka pësuar lëndime te renda trupore,

Ne rastin konkret ne raport me çështjen penale ndaj te pandehurit nuk ekzistojnë rrethana te cilat kishin me përjashtuar përgjegjësin penale për te pandehurin.

Kualifikimi ligjor për veprën penale është bere ne baze te provave materiale ne rastin konkret, mbi natyrën e lëndimeve te pësuar te dëmtuarit, ku ekspertiza mjekoligjore ka konstatuar se i dëmtuari ka pësuar lëndime te natyrës se rende trupore, dhe një kualifikim i tille është bazuar ne provat materiale te administruara.

Me rastin e caktimit të llojit të dënimit dhe matjes se lartësisë së dënimit për të pandehurin gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-ës, si rrethana renduese gjykata ka konstatuar cenim te integritet trupor qe ka rezultuar ne shkaktim te lëndimeve te renda trupore me pasoja qe ende vazhdojnë, si rrethane tjetër rendues gjykata morri faktin se këto vepra penale janë ne rritje se sipër. Si rrethane lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat nen te cilat është kryer vepra e qe këto rrethana kishin determinuar edhe pasojën e veprës penale, rrethane tjetër lehtësuese gjykata kishte vlerësuar sjelljen e mëparshëm te kryerësit gjë qe siç rezulton nga shkresat e lendes i pandehuri nuk njihej për kryerje te ndonjë vepre te mëparshme penale apo te ketë kryer ndonjë vepër pas kësaj vepre penale. Rrethane tjetër lehtësuese për gjykatën rezultojnë te jene rrethanat e tij personale dhe atë se tani me nga periudha e kryerjes se veprës penale i pandehuri kishte kujdes te shtuar ne raport me këto vepra penale, si rrethane lehtësuese për gjykatën po ashtu është vlerësuar fakti se nga koha e kryerjes se veprës penale e gjere me sot ka kaluar nje kohe e gjate, po ashtu faktin se i pandehuri kishte pasur sjellje korrekte me institucionet ligj zbatuese e po ashtu edhe ne raport me te dëmtuarin kishin arritur pajtueshmëri për veprën qe kishin ndodhur, rrethana këto qe i pohon edhe vet i dëmtuari, si rrethane tjetër gjykata morri parasysh edhe faktin se me rastin e shkaktimit te aksidentit i pandehuri menjëherë i ka dhëne ndihme dhe e ka dërguar tek qendra shëndetësore ne ..., njëkohësisht i pandehuri ka shprehur një keqardhje te thelle për rastin qe ka ndodhur dhe për te dëmtuarin.

Gjykata duke bere vlerësimet e rrethanave e duke i pasur parasysh rrethanat posaçërisht lehtësues, ka zbatuar edhe dispozitën ligjore për zbutjen e dënimit sipas nenit 75 par 1 nen par 1.2 te KPRK-se, ku thuhet se kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësues te cilat tregojnë se qëllimi

i dënimit munde te arrihet edhe me shqiptimin e dënimit me te bute, dhe ne këtë raste gjykata duke i pasur parasysh rrethanat e faktit si dhe duke i pasur parasysh rrethanat posaçërisht lehtësuese, siq është fakti se i pandehuri qe ne momentin kur kishte ndodhur rasti ia kishte dhëne ndihmën e par dhe e kishte dërguar tek qendra mjekësore ne ..., se kishin raporte te mira me te dëmtuarin, se ka shprehur një pendim te thelle për rastin qe ka ndodhur, kishte bashkëpunim te plote me organet e ndjekjes, ishte hera e par qe kishte ra ndesh me ligjin, andaj nga te gjitha këto gjykata vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, duke hyr nen minimumin e dënimit, e qe për këtë vepër penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par 8 lidhur me par 6 te KPRK-se, minimumi është 6 muaj ndërsa maksimumi është 5 vite. Po ashtu gjykata ka zbatuar edhe nenin 76 par 1 nen par 1.6 për kufijtë e zbutjes se dënimit, ku sipas kësaj dispozite ceket se nëse për veprën penale është parapare si mase me e ulte dënimi me burgim me pake se një vit, dënimi munde te zbutet deri ne tridhjetë dite burgim, e qe ne rastin konkret gjykata ka respektuar kufijtë e zbutjes se dënimit. Gjukata ka aplikuar edhe dispozitën ligjore te nenit 74 për rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit, ku ka aplikuar disa rrethana posaçërisht lehtësues e te cilat determinojnë edhe zbutjen e dënimit.

Bazuar ne te gjitha këto rrethana gjykata ka shqiptuar dënimin ndaj te pandehurit sikurse ne dispozitiv duke qene e bindur se me një dënim te tille do te arrihet qëllimi i dënimit, konkretisht qe kryesi do te parandalohet ne kryerje te veprave penale ne te ardhmen dhe do te arrihet rehabilitimi i tij, me ane te këtij dënimi po ashtu do te parandalohen personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, me ane te këtij dënimi gjykata është e bindur se shprehet edhe gjykimi shoqëror dhe forcohet detyrimi për respektimin e ligjit, qe te gjitha këto te parapara me nenin 41 te KPRK-ës.

Shpallja e aktgjykimit është bere me dt.16.07.2019, ne seance te hapur dhe publike, ne mungesën e te pandehurit dhe Prokurorit te Shtetit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori konform neneve 450 dhe 451 të KPP-ës, ndërsa udhëzimi i palës te dëmtuara për realizmin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil u mbështet ne nenin 463 te KPP-ës, andaj mbi bazën e këtyre rrethanave te dëmtuarin e ka udhëzuar ne kontestin civile juridik.

Nga te cekurat si me lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.1116/2018, dt.09.08.2019**

**Procesmbajtësja**  
**Hasnije Muhaxheri**

**Gjyqtari:**  
**Gezim Ademi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit te këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.